



OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT
DREJTORIA E PROKURIMEVE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2021

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Nga: Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.)
Adresa: Tiranë, Kashar, Yrshek, Autostrada Tiranë-Durrës, Km. 9
Kontakt: www.ost.al; e-mail: info@ost.al.

Për: **OE: “Gentian Horieti” p.f., me NIPT K31427013J**
Adresa: Rruga “5 Maji”, ish NPK, Tiranë.

Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur” - me mjete elektronike – Mallra.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje bojëra dhe aksesorë për lyerjen e shtyllave TL”.

Kohëzgjatja e kontratës: 2 (dy) muaj nga hyrja në fuqi e kontratës.

Fondi Limit: 10,000,000 (dhjetë milion) Lekë pa TVSH, nga të ardhurat e OST sh.a.

Numri i references i procedurës: REF-80150-11-26-2020

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: Datë 21.12.2020

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike, Nr. 111, Datë 01.12.2020.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Çmimi më i ulët.

Njoftojmë se kanë qenë pjesëmarrës në procedurë 4 (katër) OE ofertues, me vlerat përkatëse të ofruar si më poshtë:

1. **OE “DEUTSCHCOLOR” sh.p.k.,** me NIPT **L21326504J**
me ofertë ekonomike 6,007,600 (gjashtë milion e shtatë mijë e gjashtëqind) Lekë pa TVSH.
2. **OE “GENTIAN HORIETI p.f.** me NIPT **K31427013J**

me ofertë ekonomike 7,987,500 (shtatë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind) Lekë pa TVSH.

3. OE “OL-VAHROM” sh.p.k. me NIPT J93316628U

me ofertë ekonomike 8,083,000 (tetë milion e tetëdhjetë e tre mijë) Lekë pa TVSH.

4. OE “DOALPAINT” sh.p.k. me NIPT K73206204L

me ofertë ekonomike 9,898,600 (nëntë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind) Lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. OE “Deutschcolor” sh.a., me NIPT L21326504J, për arsye se:

- Nuk ka përmbushur pikën 1/e të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, Shtojca 9 e Dokumenteve të Tenderit, pasi Vërtetimi i pagesës së faturave të maturuara të energjisë elektrike nuk disponon të gjithë kontratat e OE ofertues, sipas adresave të paraqitura në Ekstraktin e QKB, në të cilin ka 20 adresa, ndërsa në Vërtetim ka 16 kontrata.
- Nuk ka përmbushur pikën 2.3.4 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, Shtojca 9 e Dokumenteve të Tenderit, pasi katalogu i paraqitur nga OE ofertues është në gjuhën angleze, ndërsa referuar pikës 4.6 të Njoftimit të Kontratës në Dokumentet e Tenderit, është përcaktuar se gjuha për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje është shqip.
- Nuk ka përmbushur pikën 2.3.6 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, Shtojca 9 e Dokumenteve të Tenderit, pasi mostrat e paraqitura për mallrat furçë për lyerje, rrul për lyerje dhe bishta rruli për lyerje, nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara, konkretisht:
 - Furça për lyerje është paraqitur më e vogël se sa është kërkuar në madhësinë ≥ 7 cm.
 - Rruli për lyerje është paraqitur më i vogël se sa është kërkuar në madhësinë ≥ 10 cm.
 - Bisht rruli për lyerje është paraqitur më i vogël se sa është kërkuar në madhësinë ≥ 20 cm

2. OE “OL-VAHROM” sh.p.k., me NIPT J93316628U, për arsye se:

- Nuk ka përmbushur pikën 1/e të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, Shtojca 9 e Dokumenteve të Tenderit, pasi Vërtetimi i pagesës së faturave të maturuara të energjisë elektrike nuk disponon të gjithë kontratat e OE ofertues, sipas adresave të paraqitura në Ekstraktin e QKB, në të cilin paraqiten 4 adresa, ndërsa në Vërtetim paraqitet 1 kontratë me Kod GJ1K...377.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë OE “GENTIAN HORIETI” p.f., me NIPT K31427013J, Adresa: Rruga “5 Maji”, ish NPK, Tiranë, për vlerën

7,987,500 (shtatë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind) Lekë pa TVSH, është identifikuar si ofertë e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Prokurimeve të OST sh.a., me adresë *Tiranë Kashar Yrshek, Autostrada Tiranë - Durrës, Km 9*, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentet e tenderit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes së publikimit së këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, procedohet, siç parashikohet në nenin 58, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 29.12.2020.

Ankesa: Po.

Ka marrë përgjigje në datë 11.01.2021, nga KSHA.

Ka marrë përgjigje në datë 12.05.2021, nga KPP.

ADMINISTRATORI I OST SH.A.

Skerdi Drenova